



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E PRISHTINËS
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prishtinës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Luljeta Sylaj*, udhëheqës ekipi dhe anëtarët *Alban Beka* dhe *Syeda Oruqi*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Zukë Zuka*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Qeverisja e mirë.....	31
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	34
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	43
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	45

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Prishtinës për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 01/11/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i Çështjes

Si theksim të çështjes, përmendim faktin se shpenzimet në vlerë 1,432,918€ ishin realizuar dhe raportuar gabimisht në kategori ekonomike. Prej tyre pagesat në vlerë 1,202,902€ ishin të buxhetuara gabimisht si investime kapitale derisa i takonin mallra dhe shërbimeve.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës, gjatë procesit të auditimit.

Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet në vlerë 1,432,918€ ishin realizuar dhe raportuar gabimisht nëpër kategori ekonomike, si në vijim:

- Shpenzimet për mallra dhe shërbime (Mirëmbajtja e sipërfaqeve publike, deratizimin e podrumëve, trajtimin e qenëve endacak, zgjedhjen e sportistit të vitit, dezinfektimin hapësinor, art në hapësira publike), janë paguar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Vlera totale e tyre ishte 1,202,902€ dhe të njëjtat kishin qenë të buxhetuara në

programin për investime kapitale . Keq klasifikimet¹ e tilla kanë ndodhur edhe në vitet e mëhershme; dhe

- Pagesat për shpenzime të naftës në vlerë 114,993€, ishin ekzekutuar përmes Thesarit nga kategoria e investimeve kapitale. Po ashtu, përmes vendimeve gjyqësore dhe pagesave direkte nga Thesari, ishin ekzekutuar pagesa në vlerë 115,023€ nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve për pagat jubilarë të punonjësve të pensionuar.

Sipas komunës këto janë pasojë e buxhetit të kufizuar për mallra dhe shërbime, të cilat janë të domosdoshme, andaj edhe janë aprovuar me ligjin e buxhetit. Në mungesë buxheti nuk ishin paguar edhe shpenzimet për derivate të naftës, andaj ishin ekzekutuar direkt nga Thesari. Pavarësisht arsytimit të prezantuar, sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik këto konsiderohen shpenzime operative dhe do të duhej të paguhen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Derisa për pagat jubilarë komuna nuk kishte planifikuar buxhet. Opinioni jonë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Çështjet kyçe të auditimit

Çështjet të cilat në gjykimin profesional të auditorit paraqesin rëndësi të veçantë për auditimin e PFV-ve janë çështjet që komuna duhet adresuar në kontekst të auditimit të PFV-ve si tërësi. Në këtë aspekt ne paraqesim çështjet në vijim:

- Ne kemi raportuar edhe vitin e kaluar për marrëveshjen që Komuna ka nënshkruar me Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA) për zbatimin e projektit “Iniciativa për qëndrueshmëri ekonomike rurale” për subvencionim të fermerëve të rajonit të Prishtinës. Projekti është tre vjeçar, me participim 1,500,000€ nga komuna dhe 337,425€ nga ADA. Derisa zbatues i projektit ishte zgjedhur Care Osterreich. Deri më tani Komuna ka transferuar 1,112,746€ tek zbatuesi i projektit, nga të cilat vetëm 464,440,99€ janë shpenzuar. Mjetet e lira prej 648,305€ kanë mbetur në llogari të Care Osterreich, të cilat pritet për t’u transferuar tek fermerët pasi ata të përmbushin kushtet e paracaktuara nga ADA. Gjatë vitit 2019 do të përcjellët zbatimi i projektit nga ana e dy palëve nënshkruese të marrëveshjes; dhe
- Gjatë vitit 2018 Komuna e Prishtinës kishte detyrime kontigjente me vlerë 38,280,748€ që përfshin periudhën kohore nga viti 2004². Krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje enorme të detyrimeve kontigjente, vlera e të cilave në vitin 2017 ishte 6,180,290€. Kryesisht këto lëndë kanë të bëjnë me: Kompensim dëmi për pronë private (përfshirë ato nga lufta), mos përmbushje të kontratës apo ndërprerje të saj, kontestet për leje ndërtimi, etj. Sipas komunës, kjo është kompetencë e gjykatave dhe nuk dihet përfundimi i tyre. Megjithatë, nëse paditë

¹ Keq klasifikimet janë konfirmuar edhe nga ana e komunës në PFV, ne kemi vendosur vlerën e keq klasifikimeve në bazë të mostrimit.

² Sipas komunës për shkak të rritjes së numrit të gjyqtarëve në gjykatën e apelit, që ka ndodh në fillim të vitit 2018, janë aktivizuar edhe lendet e vjetra, të cilat më pas i kanë shkruar komunës.

gjyqësore vendosen në favor të operatorëve, organizata pritet të ballafaqohet me vështirësi buxhetore në vitin e ardhshëm.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës së Prishtinës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr.01/2013 (Shpenzimet publike) dhe nr.02/2013 (Menaxhimi i Pasurisë);
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Raportet tremujore dhe mujore për progresin e projekteve kapitale, faturat e papaguara, të hyrat;
- Raporti për financimin e OJQ-ve; dhe
- Planin e prokurimit dhe raportin për kontratat e nënshkruara.

PFV-të janë përgatitur në pajtueshmëri me formatin për raportim, si dhe janë nënshkruar dhe dorëzuar brenda afatit ligjor në MF. Komuna ka korrigjuar PFV-të brenda afatit mirëpo sfiduese mbetet keqklasifikimi i shpenzimeve.

Në anën tjetër, megjithëse Komuna e bazuar në rregulloren nr.04/2017 – Procedurat e Financimit publik të Organizatave Joqeveritare (OJQ) neni 26, duhet të përgatis raportin vjetor të mbështetjes financiare për OJQ dhe të dërgoj një kopje elektronike të raportit, Zyrës së Kryeministrit, më së largu deri më 1 mars. Komuna e kishte bërë këtë raport mirëpo e kishte dërguar me vonesë, tek në vitin 2019.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi B1 ³Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e theksuara në opinionin e auditimit dhe te çështjet kyçe. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve jo-kapitale dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të obligimeve të papaguara.

³ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Prishtinës kishte shpenzuar 71% të buxhetit final për vitin 2018, që nënkupton një realizim jo të kënaqshëm në nivel të përgjithshëm. Sfidë mbetet niveli i ulët i realizimit të investimeve kapitale, çështje e përcjellë në vijimësi. Rreth 47% e buxhetit të investimeve kapitale ishte shpenzuar në tremujorin e fundit, derisa vetëm në dhjetor ishin shpenzuar 3.9 mil.€ apo 23% e total shpenzimeve për kapitalet. Kjo paraqet një tregues se të projektet kapitale ka vonesa si në kryerjen e punëve ashtu edhe tek proceset e prokurimit. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet në përgjithësi janë të përshtatshme, megjithatë nevojiten përmirësime tek mekanizmat për arkëtimin e të hyrave dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve.

Gjithashtu, kërkohet angazhim më i shtuar për përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar keq klasifikimin e shpenzimeve, zvogëluar numrin e të angazhuarve me marrëveshje të veçanta për punë jo specifike, mos ekzekutimin e pagesave në mënyrë jo të rregullt, zvogëlimin e pagesave me vendime gjyqësore dhe parandalimin e vonesave për përfundimin e projekteve kapitale.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	72,273,904	85,869,968	61,331,462	57,049,572	58,774,749
Granti i Qeverisë -Buxheti	42,211,067	41,721,497	41,646,451	37,411,514	35,638,815
Të bartura nga viti paraprak ⁴	-	13,928,726	4,426,155	3,041,711	6,382,842
Të hyrat vetjake ⁵	29,286,632	29,286,632	14,697,392	16,230,271	16,394,896
Donacionet e brendshme	-	3,115	2,469	-	10,699
Donacionet e jashtme	-	143,606	85,968	123,345	347,497
Te hyrat nga huamarrjet	776,205	786,392	473,027	242,731	-

⁴ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁵ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar në total ishte rritur për 13,596,064€. Kjo diferencë ishte si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar në vlerë prej 13,928,725€, të hyrave nga donacionet e brendshme dhe jashtme të cilat ishin 146,721€ dhe nga fondi i huamarrjes për 10,187€. Derisa me vendim të qeverisë burimet e financimit nga grandit qeveritar ishin zvogëluar për 489,569€.

Në vitin 2018, komuna ka shpenzuar 71% të buxhetit final ose 61,331,462€, me një përkeqësim prej 9% krahasuar me vitin 2017. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	72,273,904	85,869,968	61,331,462	57,049,572	58,774,749
Pagat dhe Mëditjet	30,277,155	29,750,487	29,420,508	28,128,949	27,900,604
Mallrat dhe Shërbimet	13,432,732	13,491,465	11,618,992	7,834,544	7,418,324
Shërbimet komunale	1,793,000	1,793,000	1,784,547	1,776,482	1,791,297
Subvencionet dhe Transferet	1,816,810	2,255,054	1,713,941	1,506,072	1,655,659
Investimet Kapitale	24,954,207	38,579,962	16,793,474	17,803,525	20,008,865

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për kategorinë e investimeve kapitale ishte rritur për vlerën 13,625,755€. Pavarësisht rritjes së buxhetit, vetëm 43% e buxhetit të investimeve ishte shpenzuar. Në buxhetin e vitit 2018 ishin paraparë 96 projekte, me pas janë shtuar edhe 17 projekte tjera. Nga këto projekte 35 prej tyre nuk ishin realizuar fare, derisa 30 janë realizuar nën shkallën 50%. Performanca e ulët është përsëritur nga ajo e vitit të kaluar si rezultat i kërkesave të vonuara nga njësitë kërkuuese për inicimin e procedurave të prokurimit, moszgjidhja me kohë e çështjeve pronësore, ankesat e operatorëve të cilat kanë zgjatur afatin deri te nënshkrimi i kontratave dhe vonesat e realizimit të punëve nga kompanitë;
- Buxheti për paga dhe mëditje ishte reduktuar për 526,668€ me vendimin e qeverisë⁶ në dhjetor 2018. Më pas kishte pasuar me një rritje solide rreth 1,000€ nga grandet e përcaktuara të donatorëve;
- Derisa, kategoria mallrave dhe shërbimeve kishte rritje të buxhetit në vlerë prej 58,733€; nga të cilat 3,388 ishin shtuar nga fondi i huamarrjes për performancën në arsim, dhe 55,345€ nga grandet e përcaktuara të donatorëve për projekte në arsim dhe kulturë;
- Buxheti për komunalitë nuk ka ndryshuar nga ai fillestar, ky buxhet edhe më tutje nuk po arrin të përmbushë obligimet ndaj komunalive në kohë, andaj rreth 36,594€ ishin paguar

⁶ <http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/12/Vendimet-e-Mbledhjes>

përmes përmbaruesit privat për Termokosin si dhe 290,807€ për shërbime të ujit përmes nenit 39.2; dhe

- Kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve ishte rritur për 438,245€, nga të cilat 31,795€ ishin shtuar me vendim të Qeverisë⁷ për subvencionimin e Trafikut Urban në kohën e ndotjes së ajrit, 6,450€ ishin shtuar përmes Ministrisë e Financave (MF) për 50 vjetorin e themelimit të shkollës “Hasan Prishtina” dhe 400,000€ ishin ndarë nga të hyrat e vitit paraprak për qëllim të subvencionimit të aktiviteteve kulturore dhe sociale.

Çështja B2 - Sfidat në realizimin e projekteve të planifikuara

Gjetja

Sipas Ligjit të buxhetit 2018, në tabelën 4.2 janë të parapara projektet për realizim në vitin 2018, po ashtu, “Ndryshimet në shumat e alokuara për projektet ekzistuese apo zëvendësimin e projekteve kapitale të komunave, të prezantuara në tabelën 4.2, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal (KK) dhe nga Ministria e Financave (MF).

Komuna kishte buxhetuar 38,579,962€ për të investuar në projekte kapitale, nga të cilat ka shpenzuar vetëm 43% apo 16,793,474€. Komuna e pranon këtë sfidë për të cilën sipas saj shkaktarë janë: vonesat në inicimin dhe lidhjen e kontratave, vonesat e realizimit të punëve nga kompanitë dhe mosgjidhja me kohë e çështjeve pronësore në vendet ku bëhen investimet. Për 35 projekte, apo 31% nga 113 projektet e përfshira në buxhetin e viti 2018, të cilat kanë filluar dhe ato që nuk kanë papërfunduar do të shpenzohen të hyrat e bartura apo buxheti i vitit 2019.

Në anën tjetër, për projektin “Blerja e autobusëve”, komuna nuk kishte mjete të mjaftueshme të buxhetuara. Si rezultat, Komuna ka përfunduar duke kryer pagesa⁸ në total prej 747,435 € për këtë projekt, duke marrë mjete nga projektet tjera, për të cilat kryetari nuk kishte kërkuar aprovim nga Kuvendi Komunal.

⁷ Vendimi i qeverisë, në mbledhjen e 36 vendimi 16/03/2018.

⁸ Pagesat në vlerë 179,059.87€; 168,375.43€ dhe 350,000€ janë paguar për projektin “Blerja e autobusëve” nga projektet “Tregu i qytetit”, “Rrethrotullimi Lakërishtë, Rrethrotullimi në Arbëri” dhe “Ndërtimi i infrastrukturës”. Pagesa në vlerë 50,000€ është paguar për ndërtimin e rrugëve nga projekti “Tregu i qytetit.”

Rreziku Mos-përmbushja e programit për investimet kapitale do të rezultojë në realizimin e më pak projekteve, dëmtimin e tyre meqë ngecin, gjë që ndikon direkt në mirëqenien e qytetarëve si dhe në cilësinë e shërbimeve. Me transferin e mjeteve mes projekteve dhe pa aprovim, ndryshimet nuk reflektohen në Programin për Investime Publike (PIP), e cila nuk tregon paraqitjen e drejte dhe të saktë se cilat projekte janë realizuar. Kjo do të zvogëlojë edhe zbatimin efektiv të planeve të parapara për shpenzimet kapitale.

Rekomandimi B2 Kryetari, duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në 2018 dhe më herët si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2019. Performanca buxhetore duhet të rishikohet në baza mujore për të identifikuar në vazhdimësi barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Po ashtu, ndryshimet në projektet kapitale të prezantuara në Tabelën e buxhetit 4.2 “Financimi i Investimeve kapitale Komunale” të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal, ashtu siç është e përcaktuar me ligjin e buxhetit aktual.

Çështja B3 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore

Gjetja

Sipas nenit 39.2 të LMFP, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për punët apo shërbimet e realizuara për OB, duhet të paguhet brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës. Ndërsa sipas nenit 40 të LMFP, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbaruesi.

Bazuar në kriteret e mësipërme, Thesari kishte ekzekutuar pagesa në vlerë prej rreth 1,2 mil.€ nga buxheti i komunës direkt në llogari të Operatorit Ekonomik (OE)/Përmbaruesit. Nga testimi i 23 pagesave kemi vërejtur se ekzekutimi i tyre përmes përmbarimit kishte shkaktuar shpenzime shtesë për 63,543€. Pagesat kishin ndodhur meqë punët/shërbimet ishin të përfunduara, mirëpo nuk ishin paguar sipas procedurave të rregullta për shpenzimin e parave publike si rezultat i mungesës së mjeteve buxhetore. Pagesat kishin të bënin me paga jubilarë, pagesa për shërbime, komunalë, investime, etj. Pagesat kishin ndodhur si rezultat i mosplanifikimit të buxhetit dhe mungesës së mjeteve për to.

Rreziku

Format e pagesës përmes vendimeve gjyqësore, rrezikojnë realizimin e projekteve të planifikuara kapitale apo realizimin e shërbimeve nga ku janë marrë mjetet për pagesë. Pagesat e tilla shkaktojnë dëmtim shtesë të buxhetit për shkak të shpenzimeve përmbarimore.

Rekomandimi B3 Kryetari, duhet të marrë veprimet e duhura në mënyrë që të ndërpresë praktikën e krijuar të pagesave, dhe të mos vie deri te pagesat me vendime gjyqësore ose pagesave direkte nga thesari. Shmangia e tyre duhet të bëhet duke respektuar me përpikëri rregullat e prokurimit publik (menaxhim i mirë të kontratave nga planifikimi, ekzekutimi e deri të raportimi i tyre), si dhe rregullat e thesarit lidhur me zotimin e mjeteve me kohë si dhe hapave tjerë deri në ekzekutimin e pagesave.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2018 ishin në vlerë 26,282,405€. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë 20% e të hyrave të përgjithshme, pas tyre janë të hyrat nga lejet e ndërtimit, kadastrit, taksat administrative, shfrytëzimi i hapësirave, grumbullimit të mbeturinave, etj. Po ashtu, komuna këtë vit ka pranuar edhe të hyra nga gjobat nga trafiku, gjykatat dhe agjencia e pyjeve në vlerë totale prej 2,255,224€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Tatimi në pronë	6,100,000	6,100,000	6,975,295	6,961,321	7,176,272
Taksat Komunale	23,186,632	23,186,632	19,307,109	16,598,299	17,067,414
Totali	29,286,632	29,286,632	26,282,404	23,559,620	24,243,686

Komuna e Prishtinës, kishte arritur të realizojë 89% të planit për grumbullimin e të hyrave të planifikuara për vitin 2018. Kjo kishte ndodhur si rezultat i planifikimit ambicioz për mbledhjen e të hyrave nga taksa për grumbullimin e mbeturinave, ku ishin planifikuar të mblidhen rreth 4 mil.€ derisa ishin mbledhur vetëm 1,5 mil€. Në anën tjetër plani për arkëtimin e të hyrave nga Tatimi në Pronë ishte tejkaluar derisa ai për të hyrat nga taksat komunale kishte ngecur për 27%.

Nga të hyrat e mbledhura të këtij viti dhe nga të hyrat e bartura nga viti 2017 janë shpenzuar 19,123,546€. Këtë vit 23,342,803€ janë bartur për tu shpenzuar në vitin 2019.

Çështja A1 - Vonesë në bartjen e të hyrave për shfrytëzim

Gjetja Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale L 03/L-40 neni 12 pika d dhe neni 40 pika c dhe sipas statutit të komunës neni 34 pika d, Kuvendi Komunal (KK) duhet të aprovojë çdo akt të nevojshëm për funksionimin efikas të komunës, derisa sipas nenit 52 të statutit Kryetari bën propozimet. Përkundër kësaj edhe pse komuna kishte në dispozicion të shfrytëzonte për investime kapitale rreth 13.9 mil.€ të hyra të vitit 2017, kërkesa nga kryetari në KK për bartje kishte shkuar tek në tetor 2018, kur edhe ishte aprovuar. Bartja me vonesë e të hyrave ka ndikuar në realizimin e ulët të shpenzimeve për investime kapitale dhe rritjen e obligimeve për vitin 2019. Komuna nuk kishte ndonjë shpjegim zyrtar për arsyen e bartjes me vonesë të të hyrave.

Rreziku Bartja me vonesë e të hyrave ndikon drejtpërdrejt në realizimin e projekteve kapitale që planifikohen të paguhen nga të hyrat vetanake. Kjo ndikon në përmbushjen objektive të komunës kundrejt plotësimit të objektivave ndaj shoqërisë e cila pret përmirësimin e infrastrukturës në përgjithësi.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të përshpejtoj diskutimet në Kuvendin Komunal dhe të bëj me kohë propozimet për procesin e bartjes së të hyrave vetanake. Kjo me qëllim që të hyrat e mbledhura nga taksapaguesit të shfrytëzohen në mënyrë efikase, drejt arritjes së realizimit të sa më shumë projekteve kapitale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve.

Çështja A2- Shfrytëzim i pronave me kontrata të skaduara

Gjetja Në bazë të vendimit të kuvendit në vitin 2007 ishin dhënë me qira 21 banesa për ish këshilltarët komunal. Po ashtu, me vendimin komisionit për çështje banesore në vitin 2008 ishin dhënë edhe 22 banesa tjera me qira për punëtorë administrativ. Ne kemi testuar katër raste dhe kemi gjetur se këto kontrata kanë skaduar dhe të njëjtat nuk janë vazhduar më. Qiramarrësit vazhdojnë të shfrytëzojnë banesat. Përveç kësaj edhe pse kompensimi ishte minimal pagesa e qirasë nuk ishte bërë në kohë të rregullt dhe figuronin borxhe në vlerë totale 16,171€. Sipas komunës aktualisht janë në proces të evidentimit të gjendjes aktuale të këtyre pronave që më pas të trajtohen sipas ligjit.

Rreziku Shfrytëzimi i pronave komunale me kontrata të skaduara dhe pa to, privon komunën nga e drejta për arkëtimin e të hyrave dhe ndjekjen e proceduarve gjyqësore në raste të mos arkëtimit e të arkëtueshmeve me kohë.

Rekomandimi A2 Kryetari, duhet të merr masa të shpejta në procesin e shqyrtimit të kësaj çështje për të sanuar situatën aktuale, përmes përpilimit të kontratave të reja apo dhe formave tjera ligjore që qojnë drejt arkëtimin e të hyrave për komunën dhe përdorimin legjitim të pronave.

Çështja B4- Shfrytëzimi i pronave pa kompensim

Gjetja Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale 03-L040 neni 14, Statutit të komunës neni 33.2- a, dhe Ligjit 04/L-144 vihet në pah mundësia/mënyra e dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale. Në vitin 2014 komuna kishte bërë verifikimin e të gjitha pronave komunale, në mesin e të cilave edhe ngastrat që janë në pjesën e quajtur "Zona Industriale". Të paktën 37 parcela të kësaj zone me rreth 6 hektarë, shfrytëzohen nga biznese të ndryshme pa asnjë kompensim ndaj komunës. Kjo çështje është ngritur edhe në raportin e vitit të kaluar dhe vazhdon të mbetet peng. Megjithatë, nga komuna nuk është ofruar ndonjë shpjegim konkret se pse nuk është ndërmarrë asnjë veprim për ta adresuar këtë çështje.

Rreziku Lënia e pronave komunale në shfrytëzim të bizneseve pa marrëveshje/kontratë dëmton të hyrat e komunës dhe rrit rrezikun që shfrytëzuesit të manipulojnë me ato prona. Sipas kalkulimit të thjeshtë krahasuar me qiratë tjera i bie që komuna humb së paku 6€/m² apo 360,000€/muaj.

Rekomandimi B4 Kryetari, duhet të rishikoj shkakun e shfrytëzimit të pronave pa kompensime dhe të marrë veprime për të nënshkruar marrëveshje me bizneset/shfrytëzues të pronave për kompensimin e tyre, qoftë përmes qirasë ose formave tjera ligjore.

Çështja B5- Sfidat për arkëtimin e taksave nga bizneset

- Gjetja** Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale, Nr.110-2782 parasheh ngarkesat vjetore për ushtrimin e disa veprimtarive afariste në komunë. Drejtoria e Planifikimit Strategjik, e cila është e ngarkuar me këtë çështje nuk ka informata për numrin e veprimtarive afariste që janë të obliguara të paguajnë taksën komunale. Të hyrat nga kjo taksë mbështeten në deklarin vullnetar të bizneseve, ngase atyre nuk iu lëshohet paraprakisht faturë. Në këtë vit nga kjo taksë janë mbledhur 63,227€, dhe ka rënie krahasuar me vitin paraprak kur ishin mbledhur 68,180€. Shkak i kësaj është mungesa e një baze të të dhënave për bizneset që operojnë në komunë.
- Rreziku** Arkëtimi i të hyrave bazuar në vullnetin e bizneseve dhe mungesa e të dhënave të sakta, ndikon direkt në uljen e të hyrave totale të komunës dhe në planifikim jo real të hyrave.
- Rekomandimi B5** Kryetari, të ndërmarrë masa rreth krijimit të një baze të saktë për të gjitha bizneset që operojnë në komunë dhe janë obligues ndaj kësaj takse bazuar në rregulloren e nxjerrë në Kuvendin Komunal. Me tutje të sigurojë se bizneset faturohen në baza të rregullta dhe merren të gjitha veprimet e duhura për arkëtimin e tyre.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhet përmes një sistemi të centralizuar (payroll) që menaxhohet nga MF. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave, nënshkrimin e listave të pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, azhurnimin e dosjeve të personelit si dhe rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Buxheti final për pagat dhe mëditjet ishte 29,750,487€ përderisa shpenzimet ishin 29,420,508€.

Çështja C1 - Mangësi tek kontratat për shërbime të veçanta**Gjetja**

Sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, neni 12, pika 4 dhe Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, neni 10, lejohet lidhja e kontratave për shërbime të veçanta dhe detyra specifike. Në bazë të kësaj komuna për realizimin e shërbimeve të domosdoshme, kishte angazhuar 94 persona përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta (MShV). Ne kemi testuar 10 raste dhe kemi gjetur se:

- Në pesë (5)⁹ raste angazhimi nuk ishte bërë përmes procedurave të thjeshtëzuara të rekrutimit siç kërkohet. Personat ishin angazhuar për 6 muaj dhe më pas kontratat iu kishin vazhduar edhe për 6 muaj me kërkesë të drejtorëve përkatës ku ishin angazhuar më parë. Personat punonin në pozita të rregullta të punës. Sipas komunës kjo ishte pasojë e mungesës së pozitive të aprovuara në planifikimin e buxhetit dhe mundësia me e lehtë e angazhimit të tyre. Tek një rast kishin zhvilluar procedura rekrutimi; dhe
- Në katër (4)¹⁰ raste tjera, të cilët që nga muaji shkurt 2015 ishin angazhuar me MSHV (në Kuzhinën Qendrore në Insuticionin Parashkollorë) vazhdimisht iu kishin përtërirë kontratat. Derisa nga mesi i vitit 2017 kishin kontrata pune për kohë të pacaktuar dhe paguhen përmes MSHV nga mallrat dhe shërbimet. Kjo kishte ndodhur për shkak të vendimit të inspektoratit të punës, i cili kishte rekomanduar që t'iu bëhen kontrata deri në gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme.

Rreziku

Mbulimi i pozitive me MSHV për pozita të rregullta, pa procedura të thjeshtësuara kufizon konkurrencën dhe si pasojë mund të pranohet staf me kompetencë të ulët që ka ndikim që cilësia e shërbimeve të pranuar të mos jenë në përputhje me nevojat. Derisa mos zgjidhja e statutit të punonjësve vite me radhë mund të shtojë rrezikun për padi dhe humbje financiare për komunën.

Rekomandimi C1

Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit përmes MSHV-ve angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent dhe periudha e angazhimit të bëhet në kuadër të afateve të parapara me ligj. Ndërsa për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.

⁹ Sipas Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, neni 12, pika 4

¹⁰ Ligjit nr.03/L-212 i Punës, neni 10

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalit në vitin 2018 ishin 15,284,465€. Prej tyre ishin shpenzuar 13,403,539€¹¹, apo 88% e tij. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këtë kategori përfshijnë, shpenzimet komunale, shpenzimet kontraktuese tjera, derivatet dhe dru për ngrohje, mirëmbaja rutinore, mirëmbajtje e veturave, furnizime mjekësore, etj.

Çështjet të cilat janë identifikuar në lidhje me zotimin e mjeteve dhe pranimin e faturave në këtë kategori, janë të paraqitura te nënkapitulli 3.1.6 si çështje që reflektohen edhe te kategoritë tjera.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 2,255,054€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 1,713,941€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin për entitete publike, ndihmë në rastet e vdekjeve, bursa si dhe mbështetje për aktivitete kulturore dhe sportive, etj.

Komuna në vitin 2018 ka aprovuar ndryshime në ish rregulloren për subvencione, me qëllim të menaxhimit më të mirë të mjeteve gjatë dhënies dhe monitorimit të subvencioneve. Po ashtu, dhënia e subvencioneve ishte bërë përmes thirrjeve publike.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 38,579,962€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 16,793,474€, që paraqet një performancë më të dobët për 14% në krahasim me vitin paraprak 2017. Për më tepër, trendi i ulët i shpenzimeve tek kapitale paraqitet që nga viti 2015. Investimet kanë të bëjnë kryesisht me rregullim të infrastrukturës, qendrave sociale, çerdheve dhe përmirësime të ndryshme tek objektet dhe inventari.

¹¹ Në këtë vlerë bëjnë pjesë edhe shpenzimet për blerjen e qumështit për shkollat fillore të komunës, për të cilat ne nuk kemi dhënë ndonjë mendim meqë lënda është në hetime në Drejtorinë për hetimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit në Prishtinë me autorizimin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë Nr. PPN.I.Nr. &K/2019.

Çështja B6 -Planifikimi i dobët i sasive në kontratë

Gjetja Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (UOPP) njësi kërkuese ka përgjegjësitë të përgatis vlerësim formal të nevojave për secilin aktivitet të prokurimit, që të sigurohet që bëhen vetëm prokurime të sakta dhe të nevojshme. Në procesin e prokurimit “Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” ishte kriter çmimi më i ulët, bazuar në këtë oferta fituesi ishte me vlerë 164,403€ (kontratë publike kornizë). Ne kemi bërë krahasimet me ofertuesin e dytë me radhë dhe doli se për sasi të njëjta të furnizuara, komuna ka paguar 39,757€¹² më shumë. Pra, si shkak i vlerësimit të dobët të sasive të kërkuara dhe atyre të nevojshme për furnizim, komunës ofertuesi më i lirë i kushtoi më shtrenjtë. Rrjedhimisht për një pozicion ishin kontraktuar 50 njësi dhe janë pranuar 1302 njësi, derisa disa pozicione tjera nuk ishin marrë fare.

Rreziku Planifikimi jo i përafërt i sasive rrezikon shpërblimin e ofertuesve më të shtrenjtë edhe pse në parim gjatë vlerësimit të ofertave mund të perceptohet sikur po shpërblehet oferta me çmimin më të lirë, dhe si rrjedhojë të shkaktohet humbje financiare për komunën dhe gjithnjë ekziston rreziku i keqpërdorimit gjatë tërë procesit të tenderimit dhe ekzekutimit të një kontrate.

Rekomandimi B6 Kryetari, duhet të sigurojë se njësitë kërkuese vlerësojnë sa më saktë nevojat për punët që do të porositen në mënyrë që të mos përsëriten rastet e ngjashme. Ne do të sugjerim që me rastin e planifikimit të sasive, një rishikim i tyre të bëhet edhe nga një ekip/staf i dytë që ka njohuri për projektin e caktuar.

Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin i kontratave

Gjetja Sipas marrëveshjeve kontraktuale përcaktohen edhe obligimet e OE ndaj komunës. Gjatë auditimit ne kemi gjetur disa parregullsi lidhur me procedurat dhe realizimin e kontratave të nënshkruara:

- Së pari, në procedurën e prokurimit “Ndërtimi i disa rrugëve”¹³ në kontratë ishte paraparë sigurimi i punishtes nga një institut i sigurimeve i licencuar për këtë veprimtari. Këtu përfshihej sigurimi i tërë stafit të angazhuar në punë deri në përfundim të tyre. Në realizimin e situacionit të parë në vlerë 50,000€, OE nuk e kishte bërë sigurimin e punishtes, edhe pse sipas kontratës ky duhej dhe është tek pozicionet e para. Menaxheri i projektit nuk kishte arsyetim në lidhje me mos kryerjen e sigurimit nga OE;

¹² Komuna ka paguar për sasi të njëjta 191,394€, ndërsa sipas ofertuesit të dytë këto sasi do t'i kushtonin komunës 151,637€.

¹³ Ndërtimi i Rrugëve në Makovc, Lagja Balaj dhe Grashticë e Epërme Lagja Musaj, Rexhaj dhe Obzovik”,

- Së dyti, në projektin “Ndërtimi i objektit parashkollor në Kodrën e Trimave” gjatë ekzekutimit të kontratës, menaxheri i kontratës kishte ndryshuar disa kërkesa në kontratë si: muratimi i mureve sipas kontratës ka qenë i paraparë me blloqe të Silcaporit, ndërsa janë realizuar me blloqe nga argjila; dhe furnizimi, transporti dhe montimi i dyshemesë sipas kontratës ka qenë i planifikuar nga druri ndërsa është realizuar me pllaka. Sipas menaxherit nuk ishin paraparë pozicionet e duhura, prandaj janë ndërruar;
- Në rastin e tretë, sipas kontratës për projektin “Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në lagjen Arbëria”, periudha garantuese e defekteve është pesë (5) vite, pas pranimit të punëve. Objekti ishte pranuar në muajin nëntor 2018. Gjatë ekzaminimit tonë fizik të këtij projekti, kemi vërejtur se disa pjesë të objektit (mure, tavane) ishin shkatërruar dukshëm. Komuna nuk kishte kërkuar nga punë kryesi sanimin e këtyre prishjeve, sepse ata nuk kishin pranuar asnjë ankesë nga drejtorja e shkollës. Pas ngritjes së vërejtjeve tona tek komuna, ajo ka kërkuar nga OE që të bëjë sanimet e duhura; dhe
- Në rastin e katërt, sipas UOPP neni 56.11 për kontratat kornizë theksohet se në rastet kur nuk dihen sasitë indikative, atëherë Autoriteti Kontraktues (AK) duhet të përdorë kontratën me çmime për njësi ku nuk vlen pragu apo tavani plus/minus 30%. AK në dy (2)¹⁴ raste, pavarësisht se janë kontrata në bazë të çmimeve për njësi (ku nuk dihet sasia e parashikuar), komuna ka aplikuar kontratën e gabuar apo pragun plus/minus 30%. Sipas menaxherit të prokurimit kjo ka ndodhë si pasojë e mos njoftimit të ndryshimit të legjislacionit.

Rreziku

Menaxhimi dhe monitorimi i dobët i kontratave mund të ndikojë në mos zbatimin e kontratave sipas kushteve kontraktuale, rrjedhimisht në mos arritjen e objektivave dhe kërkesave të përcaktuara në kontratë. Derisa përfshirja e pragut në kontratën publike kornizë prej +/-30%, kur nuk kërkohet, paraqet rrezik për entitetin pasi që, OE mund të kërkojë përmbushje të saj. Po ashtu pakujdesia për mos aplikimin e periudhës garantuese shkakton shpenzime shtesë për komunën.

Rekomandimi A3 Kryetari i komunës të sigurojë se menaxherët e projektit kujdesen që të kryhen të gjitha punët/shërbimet sipas kontratës si dhe pas pranimit të punëve të bëhen vizita në mënyrë që gjatë periudhës garantuese të bëhen sanimet e nevojshme, aty ku paraqitet nevoja. Po ashtu kontratat duhet të lidhen ashtu siç kërkohen me udhëzimet e prokurimit publik.

¹⁴ Kontrata “Hartimi i projekteve të infrastrukturës rrugore në Prishtinë” dhe kontrata “Ndërtimi i sistemit të ujitjes dhe shpimi i puseve.

Çështja B7 - Vonesa në realizimin e projekteve

Gjetja

Sipas kontratave të lidhura mes komunës dhe OE janë paraparë edhe afatet kohore për realizimin e projekteve: Nga testimi i 100 pagesave kemi identifikuar vonesat si në vijim:

- Projekti i ndërtimit të Bulevardit mbi kurriz, me vlerë 977,725€, për të cilin është nënshkruar kontrata me 12.06.2015 është paraparë të përfundojë pas 180 ditësh, por kontrata nuk është përfunduar ende. Komuna nuk ka aplikuar penale. Në fund të vitit 2018 menaxheri i prokurimit bazuar në raportin e komisionit të vlerësimit të punimeve ka propozuar që kjo kontratë të mbyllet, por kjo nuk është bërë. Shkak i vonesave ishte menaxhimi joadekuat i kontratës, derisa për përfundimin e kontratës po pritet aprovimi i kryetarit;
- Kontrata “Ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të Unazës Qendrore” ishte nënshkruar me datë 29.07.2016 dhe sipas kontratës duhej të përfundonte brenda 180 ditësh, nuk ka përfunduar ende. Deri në përfundim të vitit 2018 janë realizuar punë në vlerë 706,976€ ose vetëm 36% e vlerës së kontratës. Po ashtu kontrata “Revitalizimi i shkollëve dhe ndërtimi i mbikalimit në lagjen Arbëria” nënshkruar me 05.02.2018, duhej të përfundonte për 120 ditë. Deri në përfundim të vitit 2018 janë realizuar punë në vlerë 102,875€ ose vetëm 22% të kontratës. Tek këto raste shkak i vonesave ishin dobësitë në projekt;
- Kontrata “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën “Eqrem Qabej” ishte nënshkruar me datë 29.10.2014, sipas së cilës do të mbyllej pas 100 ditësh. Punët nuk ishin kryer sipas kontratës në shkollën Eqrem Qabej por në shkollën e Barilevës. Kontrata ka përfunduar gjatë vitit 2018. Sipas menaxherit shkak i kësaj ishte vlerësimi jo real i planit të ndërtimit;
- Kontrata “Ndërtimi i kolektorit mbi lumin Prishtina” ishte nënshkruar me datë 09.08.2016, sipas kontratës duhej të përfundonte për 120 ditë dhe “Ndërtimi i kanalizimit Besi-Barilevë-Lebanë-Kodra e Trimave” nënshkruar me 18.08.2017 sipas kontratës duhej të përfundonte për 60 ditë. Deri në përfundim të vitit 2018 për të parin janë realizuar punë në vlerë 1,235,791€ ose 56% e kontratës, dhe për projektin e dytë punë në vlerë 60,000€ ose vetëm 30%. Këto dy projekte ende nuk kanë përfunduar. Komuna nuk kishte zgjedhur paraprakisht problemet pronësore që lidhen me këto projekte si shkak i të cilave janë vonuar realizimet. Tek projekti i dytë ishte vonuar edhe OE ndaj të cilit kishin aplikuar penale; dhe

- Kontrata “Rregullimi i Rr “Reshat Maliqi”, “27 Nëntori”, dhe Te Trafoja si dhe rregullimi i infrastrukturës në rrugët “Aziz Kelmendi”, “Malush Kosova” dhe “Elena Gjika” ishte nënshkruar me datë 24.10.2017 dhe sipas kontratës të gjitha punët do të përfundonin për 150 ditë. Deri në përfundim të vitit 2018 janë realizuar punë në vlerë 50,000€ ose vetëm 14.6% e kontratës. Vonesat i kishte shkaktuar operatori i papërgjegjshëm. Menaxherja e projektit ka dërguar vërejtje për OE si dhe ka informuar zyrën e prokurimit rreth vonesave, megjithatë, gjatë pagesës së situacionit të parë nuk janë aplikuar penale.

Rreziku Mosrealizimi i projekteve sipas planit dinamik dhe kushteve të kontraktuara, dhe fillimi i punimeve pa zgjidhur problemet pronësore, ka ndikuar në tejzgjatjen e realizimit të projekteve gjë që dëmton vet cilësinë e punimeve dhe mbi të gjitha dëmton perceptimin e qytetarëve ndaj e komunës.

Rekomandimi B7 Kryetari, duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për përfundimin e projekteve të cilat po përcjellën nëpër vite. Po ashtu duhet të sigurojë se para inicimit të tyre të bëhen projektet precize, të zgjidhet çështja e shpronësimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe projektet të realizohen sipas planit dinamik.

Çështja A4 - Kryerja e punëve pa kontratë

Gjetja Sipas LPP, neni 38, kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet dhe kushtet e saj nuk mund të ndryshohen. Komuna kishte nënshkruar kontratë publike kornizë për projektin “Punimi furnizimi dhe vendosja e numrave të adresave”. Kjo kontratë ishte nënshkruar me 20.09.2016 me afat 12 muaj. Nga testimi del se furnizimet, në vlerë 17,959€ të paguara në vitin 2018, ishin bërë rreth 6 muaj mbas përfundimit të kontratës. Sipas menaxherit të kontratës, OE kishte filluar zbatimin e kontratës me vonesë, andaj është tejkalluar afati. Sipas kësaj, duket se menaxheri nuk i ka kushtuar vëmendjen afatit të përcaktuar me kontratë. Në anën tjetër, komuna nuk ka ndërmarrë masat e duhura ndaj OE që të fillojë puna me kohë.

Rreziku Komuna rrezikon të hyjë në obligime pa kontratë për shkak të menaxhimit joefektiv të kontratave. Kështu pagesat mbas përfundimit të kontratës mund të ndikojnë me humbje financiare për komunën dhe në arritje të vlerës së dobët për para.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se janë duke u përfillur kushtet mbi kontratën kornizë, të cilat janë të përcaktuara edhe me LPP (mbi kohëzgjatjen), dhe të shtojë forcimin e kontroleve, me qëllim që kontratat të menaxhohen drejtë dhe që punimet/furnizimet të mos kryhen jashtë afateve të përcaktuara me kontratë.

Çështja C 2 – Mangësi në procesin e vlerësimit të tenderëve

- Gjetja** Sipas Rregullave dhe UOPP në rast se OE, ofron çmimin 0.00€ për një artikull të veçantë duhet të dërgohet një pyetje sqaruese tek OE duke kërkuar shpjegim për të. Tek procedura e prokurimit “Ndërtimi i rrugës dhe trotuareve në fshatin Drenoc” në vlerë 367,972€, OE kishte ofertuar me çmim 0 për tre (3) pozicione, dhe nuk ishte kërkuar fare sqarim. Komisioni për vlerësimin e tenderëve nuk i kishte vërejtur këto pozicione me çmim 0.00€ dhe nuk ka kërkuar sqarimin.
- Rreziku** Mos respektimi i dispozitave ligjore të prokurimit publik mund të ndikoj në vonesa të procedurave të prokurimit meqë të njëjtat mund të anulohen dhe projektet mund të mbesin pa përfunduar.
- Rekomandimi C2** Kryetari duhet të forcojë kontrollet në zyrën e prokurimit lidhur me vlerësimin e tenderëve në mënyrë që të siguroj që komisioni për vlerësimin e tenderëve bën ekzaminimin e plotë të ofertave përfshirë pozicionet e caktuara me çmimin 0€.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja C3 - Urdhërblerja pas pranimit të faturës/punëve

- Gjetja** Sipas Rregullës Financiare 01/2013, procesit për inicimin e shpenzimit, i paraprin kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, urdhërblerja, pranimi i mallit dhe më pas fatura. Nga 200 pagesa të testuara, në 61 prej tyre, që kishin të bënin me investime kapitale dhe mallra e shërbime, nuk janë respektuar rregullat e lartcekura. Urdhërblerja dhe zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të punëve/furnizimeve, gjegjësisht pas pranimit të faturës. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos komunikimit të mirë mes palëve kompetente.
- Rreziku** Hyrja në obligime në mungesë të zotimit të mjeteve/urdhërblerjes, mund të shkaktojë rritjen e obligimeve të papaguara dhe si pasojë, ekzekutimin e pagesave direkt nga Thesari.
- Rekomandimi C3** Kryetari, duhet të sigurojë se, stafi përgjegjës respekton hapat e përcaktuar ligjor mbi procesin e shpenzimeve, ku me rastin e inicimit të shpenzimit, të sigurohet se ekziston zotimi i mjeteve dhe krijimi me kohë i urdhërblerjes.

Çështja B8 - Lidhja e kontratave në mungesë të zotimit të mjeteve

- Gjetja** Sipas Rregullës Financiare 01/2013, asnjë kontratë nuk duhet të nënshkruhet pa zotimin paraprak dhe se zotimi duhet të jetë pjesë përbërëse e kontratës. Në shtatë¹⁵ (7) raste nga 11 të testuara, kontratat janë nënshkruar pa zotim të mjaftueshëm të fondeve. Vlera totale e kontratave të nënshkruara ishte 2,401,843€, derisa zotimi i mjeteve për to ishte vetëm 310,000€ ose rreth 13% të vlerës së kontratës. Sipas zyrtarëve të komunës mos alokimi me kohë i të hyrave vetjake ka rezultuar me nënshkrim të kontratave pa zotim të plotë të mjeteve.
- Rreziku** Hyrja në obligime pa fonde të zotuar rritë rrezikun që të mos mund të financohen në tërësi projektet dhe të rezultojë me dështim të kryerjes së tyre ose pagesa direkte nga Thesari.
- Rekomandimi B8** Kryetari, të sigurojë se asnjë kontratë nuk nënshkruhet pa siguruar fondet e nevojshme dhe bërë zotimin për realizimin e saj.

¹⁵ Furnizim me inventarë për shkollë kontrata në vlerë 76,890€ ndërsa zotimi 30,000€; Ndërtimi I rrugës dhe trotuareve në fshatin Drenovc LLOT II kontrata në vlerë 367,972€ ndërsa zotimi 50,000€; Ndërtimi I rrjetit të kanalizimit në lagjet e reja kontrata në vlerë 933,447€ ndërsa zotimi 50,000€; Ndërtimi i rrugëve Evlija Çelebi, Luan Qelaj dhe Halil Ademaj – Ritender kontrata në vlerë 122,234€ ndërsa zotimi 50,000€; Sanimi dhe asfaltimi i rrugës Fehmi Lladrovci kontrata në vlerë 59,480€ ndërsa zotimi 30,000€ si dhe Revitalizimi I shkalleve dhe ndërtimi I mbikalimit në lagjen Arbëria kontrata në vlerë 463,261€ ndërsa zotimi 50,000€. “Rikonstruimi I rrugës dhe trotuareve në rrugën Vëllezërit Fazliu” në vlerë 378,558€ ndërsa zotimi 50,000€.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë së pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj.

Vlera e pasurisë kapitale e paraqitur në PFV-të 2018 ishte 2,452,784€ ndërsa vlera e pasurisë jo kapitale ishte 1,290,330€. Stoqet në fund vit ishin 264,282€.

Çështja A5 - Mos themelimi i komisionit për inventarizim të pasurisë

Gjetja Sipas Rregullores nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Kryetari duhet të themeloj një Komision për Inventarizimin e pasurisë me qëllim të inventarizimit vjetor apo periodik të pasurisë jo financiare. Gjatë vitit 2018 kjo nuk është bërë, pasi që kryetari nuk kishte themeluar komisionin për inventarizimin e pasurisë.

Rreziku Mos inventarizimi i pasurisë rrit rrezikun për informata të mangëta rreth pasurisë së komunës përfshirë këtu vërtetimin e saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare.

Rekomandimi A5 Kryetari të caktoj komisionin për inventarizim të pasurisë në mënyrë që të ketë informata të sakta vjetore apo periodike rreth gjendjes së secilës pasuri jo financiare.

Çështja B9 Dobësi në menaxhimin e pasurive

Gjetja Sipas Rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë, neni 6 dhe 10 përcaktojnë që, çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrat e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj (SIMFK dhe e-pasuri) dhe të gjitha pasuritë jo financiare, pas pranimit duhet të regjistrohen në regjistra kontabël pavarësisht a janë të paguara apo pjesërisht të paguara. Po ashtu, pranimi i pasurisë duhet të bëhet nga një komision prej tre anëtarëve për pranimin e saj. Dobësitë në menaxhimin e pasurive janë si në vijim:

- Nga testimi i shtatë (7) pagesave nga investimet kapitale, një pagesë në vlerë 56,596€, nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë, duke nënvlerësuar pasuritë për këtë vlerë. Kjo për shkak të mungesës së komunikimit ndërmjet drejtorisë së arsimit me zyrtarin e pasurisë;

- Gjithashtu, edhe objektet: 43 banesa komunale të dhëna në shfrytëzim; ish-objekti i gjykatës së Apelit; ish-objekti i gjykatës komunale; ndërtesa ku ndodhet drejtoria e inspeksionit, dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit ende nuk janë regjistruar. Po ashtu, edhe toka e shpronësuar për interes, nuk figuron si pasuri e komunës. Kjo për shkak se komuna është në pritje të një komisioni të jashtëm të nivelit qendror të cilët do të fillojnë vlerësimin e të gjitha pronave dhe vlerësimit të tokës së shpronësuar;
- Moduli e-pasuria nuk është në funksion. Stoqet regjistrohen në një regjistër të përgjithshëm të pasurive jo-kapitale në aplikacionin excel. Megjithëse, të dhënat janë mjaft të strukturuar në këtë data bazë, ato mirëmbahen në mënyrë manuale. Sipas zyrtarëve nga komuna, pritet që gjatë vitit 2019 të dhënat të barten në sistemin e- pasuria dhe të fillojnë me aplikimin e regjistrimit të pasurive jo kapitale në të; dhe
- Te furnizimi me pajisje të IT (74,655€), nuk ishte caktuar komisioni për pranimin e mallit. Malli ishte pranuar nga drejtorët e shkollave.

Rreziku

Mungesa e informatave të sakta rreth pasurisë, pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Si rrjedhojë e mungesës së regjistrimit të pasurisë, regjistri i tyre është i nënvlerësuar, andaj ekziston rreziku i keqpërdorimit të tyre. Po ashtu, mirëmbajtja manuale e të dhënave paraqet rrezik për lëshim gabimesh. Në anën tjetër, pranimi i mallit në mungesë të komisionit relevant të pranimit, mund të shpie në pranimin e mallit jocilësor dhe jo në përputhje me kushtet e kontraktuara.

Rekomandimi B9 Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurive në mënyrë që këtij të fundit t'i ofrohen dokumente të mjaftueshme për regjistrimin e pasurive. Me tutje duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-pasuria për evidentimin e pasurive nën 1,000€.

3.3 Të arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshmeve (LIA) në fund të vitit 2018 ishte 45,117,657€, të cilat kishin të bënin me tatimin në pronë, menaxhimin e mbeturinave, lejet e ndërtimit, qiraja komunale, për shpronësimet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe shfrytëzimi i hapësirës publike. LIA, (filluar në vitin 2018) nga menaxhimi i mbeturinave ishin në vlerë prej 2,317,319€.

LIA nga Tatimi në Pronë përbën 71% të totalit të borxheve. Komuna në vitin 2018 ishte angazhuar në mbledhjen e këtyre borxheve, si dhe kishte lëshuar disa vërejtje si masë për inkurajimin e të gjithë obliguesve të komunës që të paguajnë obligimet e tyre, megjithëse disa prej tyre i ishin përgjigjur pagesave edhe më tutje ky borxh mbetet shqetësues.

Çështja C4 - Sfidat në menaxhim e Llogarive të Arkëtueshmeve

Gjetja Komuna nuk po arrin të menaxhoj në mënyrë efektive LIA. Ne kemi raportuar edhe vitin e kaluar për mangësitë e vërejtura si:

Llogaritë e Arkëtueshme prej 10,580,447,58€ janë nga tatimi në pronë për ndërmarrjet shoqërore të cilat administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), e që kjo përbën 23% të totalit. Vlera prej 1,515,485€ janë të arkëtueshme të ndërtesës qeveritare ish "Rilindja" e cila që nga viti 2008 shfrytëzohet si objekt qeveritar dhe është shpronësuar në vitin 2013, ku nga kjo periudhë, ky borxh arrin në 287,092€. Kjo çështje është përsëritur nga viti i kaluar, derisa sipas komunës, ajo është duke u trajtuar.

Në Sistemin e Tatimit në Pronë (Protax) figurojnë të paktën 53 prona pa pronarë, gjë që rritë LIA në mënyrë fiktive për të paktën 96,852€, e të cilat nuk janë fshirë ende nga sistem. Për menaxhimin e përdoret sistemi Protax¹⁶ i cili menaxhohet nga MF dhe saldot e llogarive merren të mirëqena nga sistemi.

E njëjta gjendje për LIA të rritura dhe fiktive është edhe tek menaxhimi i mbeturinave për të cilat janë përdorur të dhënat e personave nga regjistri i Protax.

Komuna nuk ka informata se sa është borxhi nga taksat në biznes për të cilat nuk ka lëshuar faturë.

Shkak i këtyre mangësive sipas komunës janë: çështjet legislative, sistemi Protax dhe numri i pamjaftueshëm i zyrtarëve tek drejtoritë përkatëse në Komunë.

Rreziku Niveli i lartë i të arkëtueshmeve dhe jo efikasiteti në mbledhjen e tyre mbeten sfidë edhe për periudhën e ardhshme. Mos arkëtimi i të arkëtueshmeve rrezikon që ato vjetërsohen dhe të bëhen të pa mbledhura duke krijuar një humbje të drejtpërdrejtë financiare për Komunën.

Rekomandimi C4 Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore apo plane veprimi, me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve.

¹⁶ Në vitin 2008, MF në bashkëpunim me Agjencinë Suedeze të Tatimeve (në tekstin e mëtejme AST) dhe financim të Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (në tekstin e mëtejme SIDA), ka hartuar projektin Pro Tax me qëllim të regjistrimit të plotë dhe të drejtë të tatimit në pronë në mënyrë që të ndihmoj në përmirësimin e efikasitetit të administratës dhe të rris të hyrat në nivelin komunal.

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 7,518,082€, të cilat ishin rritur në mënyrë të ndjeshme krahasuar me vitin e kaluar kur ishin 1,262,953€. Rritja më e madhe e obligimeve ishte tek Investimet Kapitale si rezultat i Vendimit të Kuvendit Komunal për pagesën e 6,273,464€ për dhënien e ndihmës NPL Pallati i Rinisë¹⁷ dhe IMN Kosova, i cili vendim ende nuk është legjitimuar nga MF. Derisa obligimet tjera ishin rezultat i arritjes me vonesë të faturave, mos kompletimit të lëndëve, mungesës së mjeteve, etj. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019.

Çështja A6 – Vonesa dhe mos raportimi i obligimeve

Gjetja Rregulla financiare 02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të Organizatave Buxhetore (OB), neni 5 thekson se “Raporti mujor i obligimeve të papaguara”, duhet të përfshijë gjendjen e obligimeve të periudhës raportuese, përfshirë këtu të gjitha obligimet, pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur”. Po ashtu, OB duhet që çdo faturë të vlefshme për pagesë, ta paguaj brenda 30 ditësh nga data e pranimit të faturës. Ne kemi vërejtur se:

- Nga 13 mostrat e testuara, në katër (4) prej tyre me vlerë 56,797€ komuna nuk i kishte deklaruar në PFV edhe pse shërbimi kishte ndodhur në vitin 2018. Derisa në një rast kishte deklaruar obligime në vlerë 29,608€ edhe pse sipas menaxherit të kontratës ky shërbim nuk ishte ofruar por pretendohet për të;
- Në pesë (5) fatura me vlerë 127,830€, komuna ka vonuar pagesën e tyre pa dhënë shpjegime nga 8 ditë deri 5 muaj vonesë; dhe
- Në pesë (5) raste me vlerë 56,806€, faturat nuk ishin protokolluar.

Shkaku mos deklarimeve të plota dhe mos protokollimit është si pasojë e pakujdesisë së zyrtarëve përgjegjës, ndërsa për vonesat, nga zyrtarët nuk ka shpjegim se pse faturat nuk janë paguar me kohë.

Rreziku Kontrolllet e dobëta në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve paraqesin pasqyrim jo të drejtë të obligimeve, ndërsa vonesat në pagesa krijojnë implikime buxhetore për vitin fiskal vijues si dhe mundësinë e ekzekutimeve direkt nga Thesari.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të shikojë procesin e prezantimit të obligimeve dhe e pagesave të faturave për të identifikuar dobësitë në proces. Po ashtu të sigurohet se faturat protokollohen.

¹⁷ Pallati i Rinisë ka kaluar nën menaxhimin e komunës në fund të vitit 2018.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekzistojnë disa mangësi sa i përket qeverisjes brenda komunës, veçanërisht në lidhje me zbatimin e ulët të rekomandimeve nga viti paraprak, monitorimin e listës së rreziqeve, mungesë iniciativash konkrete në rritjen e të hyrave, ngecjet tek realizimi i Investimeve Kapitale dhe mos efikasiteti i auditimit të brendshëm si katalizator i efikasitetit të kontrolleve të brendshme.

Sipas Ligjit për planifikimin hapësinor planifikimi i nivelit lokal bëhet përmes tri dokumenteve: Plani Zhvillimor Komunal; Harta Zonale e Komunës; dhe planet Rregulluese të Hollësishme.

Aktualisht komuna vazhdon të ketë Planin Zhvillimor Komunal 2012-2022, i cili ishte monitoruar. Po ashtu komuna ka krijuar grupet për hartimin e hartës zonale si dokument fillestar për krijimin e strategjisë, pas së cilës do të krijohet Plani i ri Zhvillimor Komunal. Asistencë teknike/financiare për hartimin e planit të ri zhvillimor komunal dhe hartës zonale do të ofrojë Ministria e Mjedisit dhe planifikimit Hapësinorë.

Komuna ka të hartuara tri plane të hollësishme rregulluese: plani rregullues i hollësishëm për blloqet "B17", "B18", "B19" dhe "B20", ai për tërësinë Urbane "B" të lagjes Prishtina e re dhe plani rregullues për "Sofalia 2016-2024".

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me katër (4) anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së (aktualisht UD) dhe tre auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Komiteti i Auditimit ishte formuar dhe ka mbajtur 4 takime nga të cilat kishte rezultuar hartimi dhe miratimi i planit dhe statutit të NJAB-së.

Çështja C5 - Sfidat në funksionimin e auditimit të brendshëm

- Gjetja** Sipas planit vjetor të Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) ishin planifikuar të kryhen gjashtë (6) auditime. NJAB, për vitin 2018 kishte finalizuar vetëm një raport e që kishte të bënte me Menaxhimin e pasurisë në komunë. Kjo vjen si rezultat i menaxhimit jo të mirë të planit të auditimit nga NJAB. Po ashtu komiteti i Auditimit i krijuar për herë të parë nuk kishte arritur ende të ndër marrë ndonjë veprim. Shkak i mosfunksionimit të kësaj njësie sipas planifikimit është sepse ka pasur sfida në udhëheqësin e kësaj Njësie.
- Rreziku** Ky rezultat tregon jo gatishmëri në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm ose për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme.
- Rekomandimi C5** Kryetari, në bashkëpunim me kryesuesin e KA-së dhe Drejtorin e ri të NJAB-së duhet të analizojnë situatën aktuale dhe të sigurojë funksionimin normal të aktiviteteve të auditimit të brendshëm komfor kërkesave ligjore me qëllim të arritjes së objektivave.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, megjithatë, masat e aplikuara nuk janë plotësisht efektive.

Çështja B10 – Mangësi në kontrollet menaxheriale

Gjetja Si pasojë e kontrolleve të pamjaftueshme menaxheriale, buxheti për investime kapitale ishte në nivel të ulët, pagesa të konsiderueshme për IK ishin bërë në tremujorin e fundit të vitit, apo 47% e buxhetit dhe të hyrat e vitit të kaluar ishin bartur vonë për shfrytëzim. Po ashtu rreth 1,2 mil€ e buxhetit ishte ekzekutuar direkt nga thesari/vendime gjyqësore. Në anën tjetër trajtimi i disa zërave nuk ka qenë adekuat si: klasifikimi i shpenzimeve në PFV, menaxhimi i të hyrave, regjistri jo i plotë i pasurive, mos kryerja e inventarizimit dhe menaxhimi i llogarive të arkëtueshme. Shkaktarët e këtyre mangësive menaxheriale janë dhënë në brendi të raportit tek kategoritë përkatëse.

Rreziku Kërkesat jo të forta të llogaridhënies dhe raportimit financiar duhet të forcohen për të përkrahur efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë.

Rekomandimi B10 Kryetari, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të Komunës së Prishtinës ka rezultuar në 25 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Raporti i AP-së ishte diskutuar në Asambleenë Komunale, por jo edhe progresi i zbatimit të Planit të Veprimit për rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, gjashtë (6) rekomandime nga viti 2017 janë zbatuar; pesë (5) në proces, dhjetë (10) nuk janë adresuar ende, derisa katër (4) rekomandime janë të mbyllura. Rekomandimi për detyrime kontigjente i deklaruar i mbyllur është paraqitur si çështje kyçe për shkak të ndjeshmërisë. Për një përkrahje më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve më poshtë).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e theksuara në opinionin e auditimit dhe të çështjet kyçe. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve jo-kapitale dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të obligimeve të papaguara.</p> <p>Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>	Nuk ka veprime për vitin 2018.	Rekomandimi i pazbatuar

2	Procesi i buxhetit	Kryetari, duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në 2017 dhe më herët si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2018. Performanca buxhetore duhet të rishikohet në baza mujore për të identifikuar në vazhdimësi barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.	Nuk ka veprime për vitin 2018.	Rekomandimi i pazbatuar
3	Pagesat nga Thesari	Kryetari, duhet të marrë veprimet e duhura në mënyrë që të ndërpresë praktikatat e krijuara të pagesave me vendime gjyqësore ose pagesave direkte nga thesari. Shmangia e tyre duhet të bëhet duke respektuar me përpikëri rregullat e prokurimit publik (menaxhim i mirë të kontratave nga planifikimi, ekzekutimi e deri të raportimi i tyre), si dhe rregullat e thesarit lidhur me zotimin e mjeteve me kohë si dhe hapave tjerë deri në ekzekutimin e pagesave.	Nuk ka veprime për vitin 2018.	Rekomandimi i pazbatuar
4	Të hyrat	Kryetari, duhet të sigurojë se bëhet një planifikim objektiv dhe të realizueshëm dhe i njëjti të duhet të përcillet me aktivitete dhe masa adekuate për zbatim.	Planifikimi dhe realizimi është bërë bazuar në mbledhjen e të hyrave nga viti paraprak.	Rekomandimi i zbatuar
5	Të hyrat	Kryetari, duhet të rishikoj shkakun e shfrytëzimit të pronave pa kompensime dhe të marrë veprime për të nënshkruar marrëveshje me bizneset/shfrytëzues të pronave për kompensimin e tyre, qoftë përmes qirasë ose formave tjera ligjore.	Komuna nuk ka arritur të zbatojë këtë rekomandim. Ka ndryshime edhe në këtë drejtori.	Rekomandimi i pazbatuar
6	Të hyrat	Kryetari duhet t'i analizojë arsyet dhe pengesat se pse kërkesat ligjore në këtë fushë nuk janë zbatuar dhe të ndërmarrë veprime shtesë që të sigurojë se në vitin vijues do të bëhet verifikimi i pronave komunale ashtu siç parashihet me ligj.	Komuna përmes angazhimit të ekipeve në teren dhe	Rekomandimi i zbatuar

			përdorimit të tablateve ka arritur të zbatoj rekomandi min.	
7	Të hyrat	Kryetari, të ndërmarrë masa rreth krijimit të një bazë të saktë për të gjitha bizneset që operojnë në komunë dhe janë obligues ndaj kësaj takse bazuar në rregulloren e nxjerrë në Kuvendin Komunal. Me tutje të sigurojë se bizneset faturohen në baza të rregullta dhe merren të gjitha veprimet e duhura për arkëtimin e tyre.	Komuna nuk ka marrë masa.	Rekomandimi i pazbatuar
8	Të hyrat	Kryetari, duhet të sigurojë që sistemi i përshtatshëm i regjistrimit është vënë në funksion për të mbështetur mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave.	Komuna ka arritur të harmonizojë të dhënat, në proces platformë digjitale.	Rekomandimi i zbatuar
9	Të hyrat	Kryetari, duhet të sigurojë se komisioni për evidentimin e shfrytëzimit të hapësirave publike duhet të bëhet para fillimit të sezoneve, me qëllim të mbarëvajtjes së procesit, dhe mbledhjes së të hyrave në kohën e duhur. Po ashtu pëlqimi të jepet nga të gjithë anëtarët e komisionit.	Komisioni është krijuar dhe kanë evidentuar hapësirat.	Rekomandimi i zbatuar
10	Pagat dhe shtesat	Kryetari, duhet të sigurojë se zyra e personelit rishikon të gjitha pozitat e harmonizuara apo edhe ato që do të jenë subjekt ndryshimi në mënyrë që t'i bëj përditësimet e nevojshme.	Meqë është futur në fuqi Ligji për pagat nuk kemi ngritur çështje të veçantë.	Rekomandimi i mbyllur i pazbatuar
11	Menaxhimi i personelit	Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit përmes MSHV-ve angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent dhe periudha e angazhimit të bëhet në kuadër të afateve të parapara me ligj. Ndërsa për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.	Për ish të angazhuarit është përsëritur kontrata. Të rinjtë merren me konkurs.	Rekomandimi pjesërisht i përsëritur

12	Menaxhi mi i personelit	Kryetari, duhet të sigurojë që pozitat menaxhuese të mbulohen nga personat kompetent me pozita të rregullta. Në rast të zëvendësimit, kohëzgjatja e funksionit si UD të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar me ligj. Derisa rekomandimi i ripërsëritur lidhur me mirëmbajtjen e dosjeve të adresohet përfundimisht këtë vit.	Janë zgjedhur disa nga UD, megjithatë vazhdon të ketë UD, për kohë më të gjatë.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar
13	Mallrat dhe Shërbimet	Kryetari të duhet të forcoj kontrollet në këtë drejtim për të siguruar se janë duke u respektuar rregullat e prokurimit publik dhe është duke u realizuar një mbikëqyrje e rregullt në menaxhimin e kontratave. Në një periudhe të pershtatshme kohore para skadimit të kontratave të fillojnë procedurat e prokurimit për të mundësuar lidhjen e kontratave të reja më kohë.	Shfrytëzohe t kontrata e AQP.	Rekomandim i zbatuar
14	Subvencionet dhe transferet	Kryetari, duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të sigurojë që subvencionet ndahen në përputhje me rregullat duke aplikuar kontrolle shtesë në monitorimin e shpenzimit të fondeve për të siguruar se subvencionet shpenzohen për qëllimin e caktuar. Në këtë aspekt komuna do të rritë kredibilitetin tek qytetarët.	Është ndryshuar rregullorja, kërkohen raportet.	Rekomandim i zbatuar
15	Investime kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë se njësitë kërkuese vlerësojnë sa më saktë nevojat për punët që do të porositen në mënyrë që të mos përsëriten rastet e ngjashme. Ne do të sugjeronim që me rastin e planifikimit të sasive, një rishikim i tyre të bëhet edhe nga një ekip/staf i dytë që ka njohuri për projektin e caktuar.	Nuk janë marrë masa.	Rekomandim i pazbatuar
16	Investime kapitale	Kryetari, duhet forcojë kontrollet në menaxhimin e procesve të prokurimit për të siguruar se komisionet e vlerësimit bëjnë vlerësim objektiv në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.	Megjithë avancimet ka mangësi.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
17	Investime kapitale	Kryetari, të sigurojë se asnjë kontratë nuk nënshkruhet pa siguruar fondet e nevojshme dhe bërë zotimin për realizimin e saj.	Nuk janë marrë masa.	Rekomandim i pazbatuar
18	Investime kapitale	Kryetari, duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për përfundimin e projekteve të cilat po përcjellën nëpër vite. Po ashtu duhet të sigurojë se para inicimit të tyre të zgjidhet çështja e shpronësimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe projektet të realizohen sipas planit dinamik, derisa kontratat	Në vitin 2018, nuk kishte masa.	Rekomandim i pazbatuar

		për furnizime planifikohen duke u bazuar në nevojat reale dhe kushteve të përshtatshme për realizimin e tyre.		
19	Çështjet e përbashkëta MSh dhe IK	Kryetari, duhet të sigurojë se, stafi përgjegjës respekton hapat e përcaktuar ligjor mbi procesin e shpenzimeve, ku me rastin e inicimit të shpenzimit, të sigurohet se ekziston zotimi i mjeteve dhe krijimi me kohë i urdhërblërjes. Më tutje komuna të sigurojë se mban librin e pranimit të faturave në të cilin protokolohen dhe evidentohet secila faturë e pranuar.	Megjithë agazhimine komunës janë evidentuar përsëri raste.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
20	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurive në mënyrë që këtij të fundit t'i ofrohen dokumente të mjaftueshme për regjistrimin e pasurive – me theks, drejtoria e kadastrit, zyra e prokurimit dhe komisionet e pranimit. Me tutje duhet të marrë të gjitha verimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-pasuria për evidentimin e pasurive nën 1,000€.	Komuna është angazhuar për regjistrimin e pasurive të reja, ende nuk ka regjistruar total pasuritë e saj.	Rekomandim i pazbatuar
21	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.	LLA ende vazhdojnë të jenë të larta komuna ende nuk ka azhurnuar regjistrat e saj për të eliminuar pronat fiktive nga të cilat krijohen LLA Komuna ka filluar lëshimin e vërejtjeve dhe tërheqjen e mjeteve përmes përmbaruesve.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar

22	Obligimet e papaguara	Kryetari, duhet të inicojë një vlerësim të ndikimit financiar që mund të kenë pretendimet dhe paditë, ndaj buxhetit të komunës, dhe të analizojë mundësitë për gjendjen aktuale në lidhje me detyrimet kontigjente.	Megjithë paditë e shumta komuna mundohet ti prapësoj ato.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar (është përfshirë te çështjet kyçe)
23	Zbatimi i rekomandimeve	Kryetari, duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime proaktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	Është përgatitur me kohë plani i zbatimit të rekomandimeve dhe është monitoruar. Megjithatë, jo të gjitha rekomandimet janë zbatuar.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar
24	Sistemi i AB	Kryetari, në bashkëpunim me kryesuesin e KA-së dhe Drejtorin e NJAB-së duhet të analizojnë situatën aktuale dhe të sigurojë funksionimin normal të aktiviteteve të auditimit të brendshëm komfor kërkesave ligjore me qëllim të arritjes së objektivave. Hapat e parë duhet të jenë aprovimi i statutit dhe planeve të NJAB-së, ndërsa me pas përmes një komiteti efektiv të ndihmojnë aktivitetet operative në vazhdim, më fokus në adresimin e rekomandimeve, në mënyrë që përfitimet nga auditimi i brendshëm të jenë sa më të larta.	Komuna ka krijuar komitetin e auditimit, dhe janë aprovuar planet dhe statuti i NJAB.	Rekomandimi pjesërisht i zbatuar
25	Raportimi menaxherial	Kryetari, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrollë kërcënimet e ekspozuara.	Vet çështjet e ngritura në raport tregojnë se shumë fusha kërkojnë përmirësim.	Rekomandim i pazbatuar
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		

1	PFV	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e theksuara në opinionin e auditimit dhe të çështjet kyçe. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve jo-kapitale dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të obligimeve të papaguara.
2	Planifikim i dhe realizimi i buxhetit	Kryetari, duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në 2018 dhe më herët si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2019. Performanca buxhetore duhet të rishikohet në baza mujore për të identifikuar në vazhdimësi barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Po ashtu, ndryshimet në projektet kapitale të prezantuara në Tabelën e buxhetit 4.2 "Financimi i Investimeve kapitale Komunale" të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal, ashtu siç është e përcaktuar me ligjin e buxhetit aktual.
3	Pagesat përmes vendimeve e gjyqësore	Kryetari, duhet të marrë veprimet e duhura në mënyrë që të ndërpresë praktikën e krijuara të pagesave me vendime gjyqësore ose pagesave direkte nga thesari. Shmangia e tyre duhet të bëhet duke respektuar me përpikëri rregullat e prokurimit publik (menaxhim i mirë të kontratave nga planifikimi, ekzekutimi e deri të raportimi i tyre), si dhe rregullat e thesarit lidhur me zotimin e mjeteve me kohë si dhe hapave tjerë deri në ekzekutimin e pagesave.
4	Të hyrat	Kryetari duhet të përshpejtoj diskutimet në Kuvendin Komunal dhe të beje me kohë propozimet për procesin e bartjes së të hyrave vetanake. Kjo me qëllim që të hyrat e mbledhura nga taksapaguesit të shfrytëzohen në mënyrë efikase, drejt arritjes së realizimit të sa më shumë projekteve kapitale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve.
5		Kryetari, duhet të mbështes procesin e shqyrtimit të kësaj çështje për të sanuar situatën aktuale përmes përpilimit të kontratave të reja apo dhe formave tjera ligjore që qojnë drejt arkëtimit të të hyrave për komunën dhe përdorimin legjitim të pronave.
6		Kryetari, duhet të rishikoj shkakun e shfrytëzimit të pronave pa kompensime dhe të marrë veprime për të nënshkruar marrëveshje me bizneset/shfrytëzues të pronave për kompensimin e tyre, qoftë përmes qirasë ose formave tjera ligjore.
7		Kryetari, të ndërmarrë masa rreth krijimit të një bazë të saktë për të gjitha bizneset që operojnë në komunë dhe janë obligues ndaj kësaj takse bazuar në rregulloren e nxjerrë në Kuvendin Komunal. Me tutje të sigurojë se bizneset faturohen në baza të rregullta dhe merren të gjitha veprimet e duhura për arkëtimin e tyre.
8	Pagat dhe mëditjet	Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit përmes MSHV-ve angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent dhe periudha e angazhimit të bëhet në kuadër të afateve të parapara me ligj. Ndërsa për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.

9	Investimet Kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë se njësitë kërkuese vlerësojnë sa më saktë nevojat për punët që do të porositen në mënyrë që të mos përsëriten rastet e ngjashme. Ne do të sugjeronim që me rastin e planifikimit të sasive, një rishikim i tyre të bëhet edhe nga një ekip/staf i dytë që ka njohuri për projektin e caktuar.
10		Kryetari i komunës të sigurojë se menaxherët e projektit kujdesen që të kryhen të gjitha punët/shërbimet sipas kontratës si dhe pas pranimit të punëve të bëhen vizita në mënyrë që gjatë periudhës garantuese të bëhen sanimet e nevojshme, aty ku paraqitet nevoja. Po ashtu kontratat duhet të lidhen ashtu siç kërkon LPP.
11		Kryetari, duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për përfundimin e projekteve të cilat po përcjellën nëpër vite. Po ashtu duhet të sigurojë se para inicimit të tyre të bëhen projektet precize, të zgjidhet çështja e shpronësimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe projektet të realizohen sipas planit dinamik.
12		Kryetari duhet të sigurojë se janë duke u përfillur kushtet mbi kontraktën kornizë, të cilat janë të përcaktuara edhe me LPP (mbi kohëzgjatjen), dhe të shtojë forcimin e kontrolleve, me qëllim që kontratat të menaxhohen drejtë dhe që punimet/furnizimet të mos kryhen jashtë afateve të përcaktuara me kontratë.
13		Kryetari duhet të forcojë kontrollet në zyrën e prokurimit lidhur me vlerësimin e tenderëve në mënyrë që të siguroj që komisioni për vlerësimin e tenderëve bën ekzaminimin e plotë të ofertave përfshirë pozicionet e caktuara me çmimin 0€.
14		Kryetari, të sigurojë se asnjë kontratë nuk nënshkruhet pa siguruar fondet e nevojshme dhe bërë zotimin për realizimin e saj.
15	Çështje të përbashkëta	Kryetari, duhet të sigurojë se, stafi përgjegjës respekton hapat e përcaktuar ligjor mbi procesin e shpenzimeve, ku me rastin e inicimit të shpenzimit, të sigurohet se ekziston zotimi i mjeteve dhe krijimi me kohë i urdhërbljes.
16	Pasuritë	Kryetari të caktoj komisionin për inventarizim të pasurisë në mënyrë që të ketë informata të sakta vjetore apo periodike rreth gjendjes së secilës pasuri jo financiare
17		Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurive në mënyrë që këtij të fundit t'i ofrohen dokumente të mjaftueshme për regjistrimin e pasurive. Me tutje duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-pasuria për evidentimin e pasurive nën 1,000€.
18	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore apo plane veprimi, me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve.
19	Obligimet e papaguar	Kryetari duhet të shikojë procesin e prezantimit të obligimeve dhe e pagesave të faturave për të gjetur ku janë dobësitë në proces. Po ashtu të sigurohet se faturat protokolohehen.
20	NJAB	Kryetari, në bashkëpunim me kryesuesin e KA-së dhe Drejtorin e ri të NJAB-së duhet të analizojnë situatën aktuale dhe të sigurojë funksionimin normal të aktiviteteve të auditimit të brendshëm komfor kërkesave ligjore me qëllim të arritjes së objektivave.

21	Raportimi menaxherial	Kryetari, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.
----	-----------------------	--

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Shpend Ahmeti

Kryetar i Komunës së Prishtinës

Data: 29. Maj 2019, Prishtinë

